

Drejtuar:

Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Dr. Dragi Rashkovskit

Lënda: Kërkesë për mendim; Kërkesë për informata shtesë

Lidhja: Shkresa juaj nr. 49-938/1 të datës 29.01.20220 (nr. ynë 03/39/1 të datës 30.01.20220)

Të nderuar,

Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me shkresë nr. 49-938/1 të datës 29.01.2020, dorëzoi kërkesë për mendim deri të Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, lidhur me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 14/20), Propozim-Rregulloren e punës së Komisionit për projektet strategjike investuese dhe Propozim-Kërkesën për marrjen e statusit të projekteve strategjike investuese.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës shqyrtoi Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 14/20), Propozim-Rregulloren e punës së Komisionit për projekte strategjike investuese, dhe Propozim-Kërkesën për marrjen e statusit të projekteve strategjike investuese, të dorëzuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim të dhënies së mendimit të Komisionit në lidhje me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Propozim-Rregulloren e punës së Komisionit për projekte strategjike investuese dhe Propozim-Kërkesën për marrjen e statusit të projekteve strategjike investuese, dhe në lidhje me nenin 21 të Ligjit për Investime Strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është e nevojshme të dorëzohen menjëherë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe aktet nënligjore, miratimi i të cilëve është përcaktuar me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.. Njëkohësisht, nevojitet një sqarim i detajuar për nenin 2 të Ligjit për investime strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht sqarimin e pjesës së dytë të nenit 2, ku përmendet **“rritja e eksporteve”**. Kjo është e nevojshme që Komisioni, në përputhje me kompetencat e tij, të përcaktojë saktë nëse bëhet fjalë për dhënie të planifikuar të ndihmës shtetërore në përputhje me Ligjin për investime strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nëse e njëjta jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës rikujton nenin 13 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, sipas të cilit çdo dhënës i ndihmës shtetërore është i detyruar t'i dorëzoj Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës një njoftim për çdo plan për dhënien e një

ndihme të re ose ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si një skemë ndihme.

Me respekt,

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски